



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:220048  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05751319

Ac.nr.10151/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Xh.K, kundër të paditurit S.T nga fshati Ll....., Komuna e P....., të cilin me autorizim e përfaqëson T.G, avokat nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1229/09, i datës 11.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit S.T nga fshati Ll....., Komuna e P....., ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1229/09, i datës 11.06.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1229/09, i datës 11.06.2021, ka vendosur si në vijim: *“I-APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë. II- DETYROHET i padituri S.T nga fshati Ll....., Komuna e Prishtinës, që paditëses t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar me dt. 21.04.2004, për shkak se me rastin e regjistrimit të automjetit Mercedes benz modeli C 150 compresor prodhim i vitit 2003 nuk i ka përmbushur detyrimet doganore, në shumë të përgjithshme prej 5,448.00 €, me kamatë sikundër mjetet e qytetarëve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të veçantë nga dt. 02.06.2009 deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh*

*nga marrja së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës”.*

Kundër këtij aktgjykimi i padituri, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovohet ankesa dhe aktgjykimin e atakuar të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Ankesa e të paditurit i është dorëzuar paditëses, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Dogana e Kosovës në Prishtinë, me datë 02.06.2009, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpapia e paditëses duke e detyruar të paditurin që paditëses t’ia kompensojë dëmin që është shkaktuar si pasojë e mospagimit të detyrimeve doganore në vlerë 5.448 € me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e më detajisht sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1229/09, i datës 11.06.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka konstatuar se në cilësi të provave materiale ka administruar provat si: aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prishtinë, me numër P.nr....., i datës 21.03.2008, si dhe vërtetimit i shërbimit doganor për vlerësimin e mallit numër 03.3.4/NR.38/V i datës 26.03.2008, ku në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr....., i datës 21.03.2008, është provuar fakti se i paditur është shpallur fajtor dhe është vërtetuar përgjegjësia penale e tij për vepër penale Mashtrimi nga neni 261 paragrafi 1 të KPRK, sepse me 21.04.2004 në Qendrën për regjistrimin e automjeteve në Graçanicë me qëllim të ikjes së pagesës së obligimit doganor dhe akcizës me rastin e regjistrimit të automjetit të tipit Mercedes benz C180 Comress, prodhim i vitit 2003 ka prezantuar librezën jugosllave të qarkullimit, kinse automjeti ka qenë i regjistruar në Kosovë më parë me targa ..... dhe mbi këtë bazë e ka regjistruar automjetin, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në vlerë prej 5,448 €, fakt i cili është vërtetuar sipas Vërtetimit të Shërbimit Doganor për vlerësimin e mallit numër 03.3.4/NR.38/V i datës 26.03.2008, ku është konstatuar se i padituri nuk e ka paguar borxhin ndaj paditëses dhe se i njëjti i ka borxh paditëses në shumë prej 5,448 €, për arsye se i padituri në mënyrë të kundërligjshme, duke i ikur obligimit doganor dhe akcizës me rastin e regjistrimit të automjetit të tipit Mercedes benz C180 Comresor, ka prezantuar librezën jugosllave të qarkullimit, kinse automjeti ka qenë i regjistruar më parë në Kosovë me targa ....., ku e ka regjistruar automjetin e theksuar dhe paditëses i ka shkaktuar

dëmin në vlerën e lartcekur. Lidhur me pretendimin e të paditurit se kërkesa e paditëses është parashkuar, gjykata gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe i papranueshëm, ngase me Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë P.nr..... i datës 21.03.2008, i padituri është shpallur fajtor dhe është dënuar me gjobë, ndërsa e dëmtuara-Shërbimi Doganor i Kosovës tani në cilësinë e paditëses është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, ndërsa padia e paditëses është paraqitur në gjykatë me dt. 02.06.2009, gjë që nuk ka arritur deri tek parashkrimi i kërkesës së paditëses sipas dispozitës së nenit 377 të LMD-së.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë vendimin e ka mbështetur në nenin 154 dhe 185 të LMD-së. Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore ka vendosur konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) dhe se përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar pretendimin ankimor të palës ankuese se i autorizuar i të paditurit në seancën e dt. 11.06.2021 nuk është ftuar dhe se gjykata ia ka pamundësuar përfaqësimin efektiv palës në procedurë, e që këtë e ka bërë në vazhdimësi edhe në seancën e dt. 12.03.2021, ku ka kërkuar që i padituri ta njoftojë avokatin e tij për seancë edhe pse i padituri nuk ka dhënë pëlqim për këtë. Këto pretendime janë të paqëndrueshme për Gjykatën e Apelit për faktin se gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore gjykata e shkallës së parë për seancën e dt. 15.02.2021 e ka ftuar të paditurin personalisht dhe paditësen, por që e ka shtyrë seancën gjyqësore, pasi që ka konstatuar se pasi që ftesa nuk iu është dorëzuar të autorizuarit të të paditurit, ka konsideruar që nuk është ftuar në mënyrë të rregullt dhe e ka caktuar seancën për dt. 12.03.2021. Nga procesverbali i seancës së dt. 12.03.2021, është konstatuar se: *“seanca e kaluar e parashikuar me dt. 15.02.2021 është shtyrë për ditën e sotme, për arsye se gabimisht i padituri është ftuar drejtpërdrejtë nga ana e gjykatës, duke qenë se i njëjti sipas shkresave të lëndës ka të autorizuar*

*përfaqësuesin av. T.G, i cili për seancën e sotme ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës, i njëjti ftesën për seancën e sotme e ka pranuar me datë 23.02.2021”, tutje ceket se: “i padituri e njofton gjykatën se përfaqësuesi me prokurë T.G avokat në Prishtinë e ka pranuar ftesën për seancën e sotme, por në pamundësi për të qenë prezent në seancë, e ka njoftuar paditësin që të vie dhe të jetë prezent në seancë” dhe pas seancës së mbajtur përgatitore, me aktvendim cekë se: “i padituri e merr përsipër të njoftojë përfaqësuesin e tij me prokurë av. T.G,” si dhe procesverbalin i padituri e ka nënshkruar pa vërejtje. Gjykata e shkallës së parë, përkundër faktit që i padituri ka marrë përsipër që ta njoftojë avokatin e tij për seancën e radhës të caktuar me dt. 21.04.2021, prapë i dërgon ftesën avokatit për seancën e dt. 21.04.2021, të cilën e ka pranuar me dt. 17.05.2021 dhe të dt. 11.06.2021, të cilën e ka pranuar me dt. 28.05.2021. Nga procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor i dt. 11.06.2021, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se seanca e parashikuar për dt. 21.04.2021 është shtyrë për ditën e sotme, për arsye se gjyqtarja e çështjes ka pasur rast vdekje, i ka vdekur nëna dhe palëve iu janë dërguar ftesat gjyqësore. Konstatimi se i padituri është ftuar në mënyrë të rregullt për seancë, respektivisht i autorizuari i tij, vërtetohet nga fletëkthesa për dorëzim personal, e cila është nënshkruar nga avokati me dt. 28.05.2021, nga çka konstaton se pala e paditur është ftuar në mënyrë të rregullt, se ftesën e ka pranuar me dt. 28.06.2021, andaj edhe seanca është mbajtur konform nenit 423.4 të LPK-së. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë asnjë shkelje procedurale në drejtim të thirrjes së palëve/dërgimit të ftesave për seancë gjyqësore, sepse nga shkresat e lëndës fletëkthesat dhe procesverbalet e seancave gjyqësore, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të drejtë, dispozitat procedurale në drejtim të dërgimit të ftesave në mënyrë të barabartë palëve ndërgjyqëse, aq më shumë, ku vetë avokati i cili nuk ka mundur të merr pjesë në seancën e dt. 12.03.2021, ku vetë pala e paditur ka ardhë personalisht në seancë dhe ka prezantuar, ku e ka njoftuar gjykatën që i autorizuari i tij nuk mund të vijë, andaj edhe gjykata më tutje nuk ka pasur për obligim që ta njoftojë për kohën e seancës së re palën që nuk ka ardhë në seancë, përkundër faktit që është thirrë në mënyrë të rregullt, që është paraparë me nenin 438.4 të LPK-së, i cili parasheh se: “Gjykata nuk ka për detyrë që të njoftojë për vendin dhe kohën e seancës së re palën që nuk ka qenë e pranishme në seancën e shtyrë përkundërit thirrjes së rregullt”, por që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë përkundër që ia ka dhënë përsipër të paditurit që ta njoftojë avokatin e tij për datën e seancës së re, prapëseprapë e ka ftuar në mënyrë të rregullt avokatin e tij me ftesë të veçantë, andaj pretendimet e të autorizuarit të të paditurit se nuk është ftuar në mënyrë të rregullt janë refuzuar të pathemelta.*

Nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike, sepse nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjes faktike, ku bazën juridike e ka vërtetuar me aktgjykimin penal të Gjykatës Komonale në Prishtinë P.nr....., i datës 21.03.2008, të formës së prerë, ku është vërtetuar fakti se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale Mashtrimi nga neni 261 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa e dëmtuara-paditësjja për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë drejtë e ka gjykuar, duke u bazuar në Vërtetimit të Shërbimit Doganor për vlerësimin e mallit numër 03.3.4/NR.38/V i datës 26.03.2008 ku është konstatuar se i padituri nuk e ka paguar borxhin ndaj paditëses dhe se i njëjti i ka borxh paditëses në shumë prej 5,448.00€, për arsye se i padituri në mënyrë të kundërligjshme, duke i ikur obligimit doganor dhe akcizës me rastin e regjistrimit të automjetit të tipit Mercedes benz C180 Comresor, ka

prezantuar librezën jugosllave të qarkullimit, kinse automjeti ka qenë i regjistruar më parë në Kosovë me targa ....., duke e regjistruar automjetin e theksuar dhe rrjedhimisht paditëses i ka shkaktuar dëmin e theksuar. Kjo për faktin se nga Aktvendimi 07/a Nr. 448 LD, i datës 16.05.2006, i lëshuar Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut ceket se me Vendimin Ekzekutiv 2003/13 të PSSP-së dhe Vendimet Ekzekutive 6/2002 të plasuara me Vendimet Ekzekutive 4/2003,13/2003, 9/2004 dhe 10/2005, është cekur se: *“banorëve të përhershëm të Kosovës ju mundësohet lirimi nga pagimi i pagesës së caktuar për regjistrim fillestar të automjeteve private, çka do të thotë se nuk kemi të bëjmë me lirim nga taksa doganore dhe taksa e akcizës”*, nga çka rezulton se i padituri ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme, e duke i shkaktuar dëm paditëses.

Përkitazi me të drejtën materiale të zbatuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit vlerëson se nga të gjeturat faktike të vërtetuara me provat e administruara në këtë çështje juridike kontestuese, gjykata e shkallës së parë drejtë ka bërë kualifikimin e fakteve në pajtim me normat materialo-juridike të zbatuara në këtë rast me referencë në dispozitat e nenit 154 dhe 185 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (LMD-së), ku me dispozitën e nenit 154 paragrafi 1 i LMD-së, përcaktohet baza e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit, ndërsa me dispozitën e nenit 185 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet detyrimi i shkaktuesit të dëmit për rivendosjen e gjendjes së mëparshme, e në pamundësi për rivendosjen e gjendjes së mëparshme, me paragrafin 2 të nenit 185 të LMD-së, përcaktohet detyrimi i kompensimit në të holla, e që në rastin konkret me aktgjykimin penal është vërtetuar fajësia e të paditurit, andaj edhe gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka detyruar të paditurin t'ia kompensojë paditësit dëmin e shkaktuar, të kërkuar në shumën e gjykuar.

Sipas nenit 14 i LPK-së, parashihet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”*

Pra, në këtë çështje juridike kontestimore, në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar fakti se ekziston baza e përgjegjësisë, pra i padituri ka shkaktuar dëm paditëses me vepër penale dhe si pasojë e kësaj ekziston edhe detyrimi i të paditurit që të bëjë kompensimin e dëmit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka gjykuar kamatën në pajtim me nenin 277 paragrafi 1 të LMD-së, si dhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në pajtim me dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i ka marrë për bazë edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës ankuese, por të cilat nuk kishin relevancë në vendosje ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:220048  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05751319

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.10151/2021, me datë 24.05.2024

Kryetare e kolegjit  
Nora Bllaca Dula, d.v